



## REPORT

### **PRAKTIKA TË MIRA, KONCEPTI, KORNIZA DHE STANDARTED E PLATFORMËS PËR MENAXHIMIN DHE SHKËMBIMIN E NJOHURIVE TË DEDIKUARA PËR QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI**

Paper prepared by: Prof. Oliver Kessler, Prof. Stefan Bruni  
and Zorica Dragic (HSLU- Lucerne), and Sokol Muça

Prill 2024

Bashki të Forta (BtF), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe  
Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Helvetas.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



**HELVETAS**

*Hartimi i këtij dokumenti politike u mundësua nga projekti “Bashki te Forta” (BtF), projekt i inicuar dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), dhe i zbatuar nga Helvetas, dhe pati bashkëpunimin kryesisht të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Departamentit të Administratës Publike (DAP), Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), shoqata e NJVV- SHAV, ‘Financat Vendore’ një projekt i SECO.*

*Gjetjet, interpretimet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC dhe të Helvetas.*

*Expertë ndërkombëtarë, Univesiteti i Lucernës: Prof. Oliver Kessler, Prof. Stefan Bruni, dhe Zorica Dragic.*



*Expert kombëtar: Sokol Muça*

*Autorët vlerësojnë të gjithë aktorët që morën pjesë në procesin e identifikimit dhe dokumentimit të rasteve dhe zhvillimin e konceptit dhe kornizës së Platformës për Menaxhimin dhe Shkëmbimin e Njohurive të dedikuara për qeverisjen vendore në Shqipëri, si dhe kontributin e ekipit të BtF-së, kryesisht Norbert Piljs, Valbona Karakaçi, Artan Rroj dhe Erton Kashta.*

*Gjetjet, interpretimet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC dhe të Helvetas*

**© Bashki të Forta-Helvetas 2024**

## Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
1. Metodologjia.....	5
2. Koncepti i përgjithshëm i platformës së menaxhimit e shpërndarjes së njohurive (KM&SH).....	6
3. Shëmbuj ndërkombëtarë të praktikave të mira për KM&SH. ....	9
3.1 Shëmbull nga Polonia.....	9
3.2 Shëmbull nga Republika Çeke .....	12
3.3 Shëmbull nga Suedia.....	13
3.4 Shëmbull nga EPALE-s .....	14
4. Praktika të mira ndërkombëtare të platformave dixhitale të të mësuarit për NJQV .....	15
5. Raste të platformave të mësimit digjital në Shqipëri.....	17
5.1 Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.....	17
5.2 Administrata.al.....	18
5.3 Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS).....	18
5.4 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë .....	19
5.5 RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) .....	19
5.6 Ministria e Kulturës.....	19
5.7 Financat e vetëqeverisjes vendore (FVV).....	20
5.8 Akademia e Microsoft-it për TIK .....	20
5.9 Sistemi arsimor 12-vjeçar dhe universitetet publike e private .....	20
6. Gjetjet metodologjike në lidhje me praktikat ndërkombëtare dhe kombëtare.....	20
6.1 Karakteristikat për të pasur sukses. ....	21
6.2 Karakteristikat që çojnë në dështim. ....	21
6.3 Pyetje në lidhje me elementët e një sistemi të suksesshëm për menaxhimin e njohurive.....	22
6.4 Çfarë duan përfaqësuesit e NJQV-ve.....	22
6.5 Përfaqësuesit e NJQV-ve e përshtatin platformën sipas nevojave të tyre. ....	22
6.6 Një bibliotekë digjitale për qeverisjen vendore .....	23
7. Përmbajtja Dhe Shërbimet .....	24
8. Procese Dhe Procedura.....	28
9. Veçori Organizative .....	29
10. Standardet Teknike .....	30
10.1 Modifikimi dhe transformimi i platformave, mundësitë dhe sfidat ekzistuese.. ..	33
10.2 Kostoja dhe çështje të tjera për tu marrë në konsideratë .....	34
<b>Shtojca 1: Rasti i Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) .....</b>	<b>35</b>

## HYRJE

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV) është i angazhuar të mbështesë forcimin e sistemit për ngritjen e kapaciteteve të NJQV-ve, sipas objektivit 6.1 të SKDQV-së, nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe, duke synuar që brenda vitit 2024 të hartohen ndryshimet strukturore përkatëse. Me propozim të MSHPV, Kryeministri nxori Urdhrin nr. 6, datë 12.01.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë dhe të stafit të NJQV-ve” (GNP), të kryesuar nga Ministri, me fushë veprimi për të ofruar propozime politikash që drejtojnë vendimmarrjen për ndryshimet strukturore, që lidhen me zhvillimin e sistemit të ngritjes së kapaciteteve për NJQV-të dhe kryesisht ngritjen e “Akademisë për NJQV-të”.

Bashki te Forta 2 (BtF2), është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Helvetas, në Shqipëri, që synon të forcojë kapacitetet e NJQV-ve, për të mundësuar një rritje të përgjithshme të performancës së njësive të qeverisjes vendore dhe të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Qeverisja e mirë vendore dhe demokracia vendore mundësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe territoreve, si dhe ofrimin cilësor të shërbimeve nga bashkitë. Projekti BtF2 mbështet zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qeverisjes kombëtare dhe vendore, punon në të 61 bashkitë dhe bashkëpunon kryesisht me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencinë për Mbështetjen e Pushtetit Vendor (ASLG/AMVV), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MASH) dhe shoqatat e NJQV-ve.

Procesi i projektimit të Akademisë dhe zbatimi i Fazës së Tranzicionit do të shoqërohet me një proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës. Sipas Urdhrit të Kryeministrit, shoqatat e NJQV-ve, SHAV dhe SHKQ, ftohen të marrin pjesë aktive në proces, pasi roli i tyre është kyç për të mundësuar mbështetje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të të gjitha NJQV-ve gjatë fazës së projektimit dhe funksionimit të qëndrueshëm institucional dhe financiar të Akademisë. Gjatë viteve 2023 dhe 2024, BtF2 mbështeti diskutimet e politikave midis Ministrisë së Brendshme (gjatë vitit 2023), dhe Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV, ASPA, DAP, Ministrisë së Financave, SHAV dhe SHKQ, dhe aktorë të tjerë me ndikim, për hartimin e një sistemi kombëtar të përmirësuar për ngritjen e kapaciteteve të NJQV-ve, me fokus ngritjen e “Akademisë për Pushtetin Vendor”. Diskutimet kanë vënë në dukje domosdoshmërinë e një procesi shumëpalësh për të identifikuar dhe miratuar modalitetet e duhura dhe të realizueshme për ngritjen e një Akademie të tillë. Diskutime të tilla politikash çuan në specifikimin e masës nr. 6.1.2 i NSDLG 2023-2030.

Një vendim i ri i Këshillit të Ministrave (prill 2024) i jep AMVV-së përgjegjësi për të koordinuar nismat për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të njësive të qeverisjes vendore. AMVV identifikon, dokumenton dhe promovon praktikën e mira të pushtetit vendor dhe u rekomandon Bashkive modele për ushtrimin e kompetencave të tyre.

BtF përfshiu ekspertizë ndërkombëtare dhe vendase për të mbështetur këtë proces dhe për të zhvilluar dokumente politikash, që ofrojnë udhëzime dhe informojnë dialogun mbi politikat, ndërmjet aktorëve të sistemit, si dhe ofrojnë një udhërrëfyes për çuarjen përpara të sistemit për ngritjen e kapaciteteve për NJQV-të. Aktorët e sistemit mbështetën variantin për një strukturë institucionale të pavarur, të veçantë (Akademia për Pushtetin Vendor), së cilës do t'i paraprijë një Fazë Tranzicioni, për të ndihmuar në skicimin e propozimeve të politikave për ngritjen e Akademisë. BtF mbështeti Fazën e Tranzicionit, për sa i përket testimit të proceseve kyçe kritike për ngritjen dhe drejtimin e Akademisë, veçanërisht mbështeti procesin e zhvillimit të një kuadri bashkëpunimi të IWG me partnerët për sa i përket zhvillimit të moduleve dhe ofrimit të trajnimeve për NJQV-të. Zbatimi i këtij kuadri po lehtësohet nga AMVV, ASPA, ministritë përkatëse dhe shoqatat e NJQV-së. BtF ka mbështetur hartimin e kornizës për themelimin e Akademisë. Një nga funksionet e Akademisë do të jetë ofrimi i njohurive dhe mësimit të vazhdueshëm për zyrtarët vendorë. Janë disa platforma në përdorim në Shqipëri, që synojnë të ofrojnë njohuri dhe të menaxhojnë procese në nivelin vendor. Ndërsa platformat janë zhvilluar dhe zotërohen e menaxhohen nga subjekte të ndryshme, analizat tregojnë se nuk ka një platformë gjithëpërfshirëse për të ofruar menaxhim dhe zhvillim të njohurive për burimet njerëzore apo shërbime të tjera.

## 1. METODOLOGJIA

Qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti politike (paper) është të ofrojë mbështetje në hartimin dhe krijimin e një platforme për menaxhimin dhe shkëmbimin e njohurive (PMSHNJ), për t'i ardhur në ndihmë akademisë për qeverisjen vendore në Shqipëri.

Detyrat e konsulentit janë:


- (i) të informojë Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP) rreth mundësive më të mira për zhvillimin e konceptit të PMSHNJ-së; si dhe
- (ii) të zhvillojë proceset e zbatimit të konceptit të PMSHNJ-së.

Objektivat do të arrihen njëri pas tjetrit, pasi rezultatet e secilit objektiv të arritur do të ndikojnë

Metodologjia për hartimin e këtij raporti përfshin:

- kryerjen e punës kërkimore dhe identifikimin e praktikave më të mira në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar;
- hartimin e një pyetësori të strukturuar për grupet e fokusit;
- konsultimin me grupet e fokusit të përbëra nga përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore;
- mbajtja e takimit me palët e interesuara të sistemit dhe agjencitë e trajnimit, për të shkëmbyer informacion dhe për të marrë mendime paraprake në lidhje me gjetjet;
- analizimi i të dhënave dhe hartimi i raportit.

Skema e mëposhtme paraqet procesin dhe produktet e mandatit të ekspertëve.



## 2. KONCEPTI I PËRGJITHSHËM I PLATFORMËS SË MENAXHIMIT E SHPERNDARJES SË NJOHURIVE (KM&SH)


Kontributi i ekspertëve ndërkombëtarë nga HSLU fokusohet në prezantimin e konceptit dhe kornizës së një platforme për menaxhimin dhe shkëmbimin e njohurive për NJQV-të, siç përshkruhet më poshtë në këtë kapitull.

Platforma e Menaxhimit dhe Ndarjes së Njohurive (KM&SH) shihet si një nga instrumentet e përdorur në konceptin dhe kuadrin më të gjerë të Akademisë së Qeverisjes Vendore. Qëllimi kryesor i krijimit të një KM&SH është nxitja e gjenerimit dhe shkëmbimit të njohurive në forma të ndryshme, për të mbështetur procesin e ngritjes së kapaciteteve dhe fuqizimin e zyrtarëve të pushtetit vendor. Së bashku me këto funksione, KM&SH do të shërbejë si një hapësirë e përbashkët virtuale për ndërveprim, shkëmbim dhe komunikim ndërmjet aktorëve në sistem, që punojnë në sektorin e qeverisjes vendore. E gjithë korniza KM&SH do të funksionojë si një kombinim i ndërveprimit mes aktorëve, proceseve dhe produkteve, i lehtësuar edhe nga një platformë elektronike me karakteristika të përparuara dhe në përputhje me standardet teknike. Inteligjenca artificiale duhet të bëhet pjesë e kësaj Platforme.

KM&SH do të përqendrohet në krijimin, ndarjen, bashkëpunimin dhe mësimin e njohurive. Ajo do të mundësojë kapjen, organizimin dhe shpërndarjen e njohurive organizative, praktikave më të mira dhe ekspertizës në nivel vendor. KM&SH do të mbështesë një gamë të gjerë të llojeve të përmbajtjes, duke përfshirë dokumente, artikuj, video, prezantime, forume dhe profile ekspertësh, të përshtatshme për kapjen e njohurive të shprehura dhe të pasqyruara. Angazhimi i përdoruesve dhe shkëmbimi i njohurive do të promovohet përmes mënyrave të tilla si forumet e diskutimit, rrjetet sociale, wikis, mësimi nga kolegët dhe komunitetet e njohurive.

Duke shërbyer si një hapësirë virtuale e përbashkët për ndërveprim ndërmjet aktorëve të ndryshëm në nivel vendor dhe kombëtar, KM&SH duhet së pari të frymëzojë përdoruesit, në të gjithë njësitë vendore, të cilët duhet të ndihen të sigurt brenda kësaj hapësire, për të ndërvepruar

dhe shkëmbyer me kolegët dhe ndërmjet niveleve dhe pozicioneve të ndryshme, të shprehin lirisht mendimet dhe qëndrimin e tyre, të jenë në gjendje të ofrojnë dhe pranojnë haptazi njohuritë e tyre. Qetësia psikologjike dhe besimi janë elementë të rëndësishëm që duhet të përfshihen në konceptin e platformës KM&SH dhe funksionimin e saj (kultura e punës).



Për ngritjen e bashkëpunimit digjital ndërmjet një rrjeti administratash të qeverisjes vendore, mund të përdoren një sërë mjetesh, të përcaktuara sipas kategorive të ndryshme. Në këtë punim paraqiten aspekte të ndryshme të alternativave të praktikave më të mira.

Skema e mëposhtme ofron një përmbledhje të kategorive të ndryshme dhe përmbajtjes së tyre që në mënyrë ideale duhet të përfshihet në një platformë për ndarjen e njohurive.

Figura në vijim paraqet një panoramë të përgjithshme të kategorive të ndryshme dhe materialet/përmbajtjet përkatëse që duhet të përfshihen në një platformë për ndarjen e njohurive.

<p><b>Mesazhet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ E-Mail</li> <li>▪ Mesazhet e çastit</li> <li>▪ Mikro blogu</li> <li>▪ Mesazhet në pajisje celulare</li> </ul>	<p><b>Produktiviteti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përpunuesit e fjalëve</li> <li>▪ Softuere me fletë pune</li> <li>▪ Softuere për</li> </ul>	<p><b>Bashkëpunimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndarja e dokumenteve</li> <li>▪ Konferenca në internet</li> </ul>	<p><b>Komunikimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Intranet/Portale</li> <li>▪ Blogje</li> </ul>
<p><b>Lidhja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Regjistri i punonjësve</li> <li>▪ Grafiku organizativ</li> </ul>	<p><b>Kontributi nga masa</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Forumet</li> <li>▪ Anketimet</li> <li>▪ Sondazhet</li> </ul>	<p><b>Mobiliteti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kompjuter/laptop/tab let</li> <li>▪ Telefoni inteligjent</li> <li>▪ Zyra qendrore</li> </ul>	



**Mesazhet** shërbejnë si një mënyrë e shpejtë komunikimi në nivel të brendshëm dhe të jashtëm, ndërsa mjetet në kategorinë e produktivitetit u bëjnë të mundur punonjësve që të kryejnë me efikasitet detyrat përkatëse. **Mjetet e bashkëpunimit** ofrojnë mundësinë për të punuar me njëri-tjetrin, ndërsa mjetet e komunikimit, nga ana tjetër, mundësojnë ndarjen e informacioneve dhe publikimin e informacioneve ose njohurive në nivel të brendshëm. **Mjetet e lidhjes** mund të jenë veçanërisht të rëndësishme në bashkëpunimin ndërmjet departamenteve, pasi bëjnë të mundur identifikimin e ekspertëve dhe kolegëve në rrjetin qeveritar. **Mjetet e kontributit nga masa** mundësojnë mbledhjen e ideve, kontributit dhe mendimeve të qytetarëve. Ndërkaq, **mjetet e mobilitetit** lehtësojnë aksesin në distancë dhe duhet të merren parasysh gjatë zbatimit të procesit të punës në distancë.

**Inteligjenca artificiale (IA)** mund të përdoret për të përmirësuar disa nga proceset e përmendura. Për shembull, mund të përdoret për analizimin e të dhënave dhe vendimmarrjen duke analizuar të dhënat historike dhe parashikuar tendencat. Në këtë mënyrë, mund të përmirësohet alokimi i burimeve dhe vendimmarrja. Me ndihmën e IA-së, menaxhimi i dokumenteve mund të automatizohet, çka do të reduktojë ndjeshëm kohën e përpunimit të të dhënave dhe të rrisë eficiencën e punës. Nëpërmjet aplikimit të Përpunimit të Gjuhës Natyrale (NLP), IA-ja mund të nxjerrë informacionet me rëndësi nga dokumentet, të përmirësojë aftësitë e kërkimit në dokumente, si dhe të automatizojë vendosjen e të dhënave.

Krahas kësaj, IA-ja mund të automatizojë detyrat e përsëritura dhe të harmonizojë proceset e miratimit, duke reduktuar barrën administrative. Së fundi, IA-ja mund të jetë veçanërisht e rëndësishme gjatë ndërveprimit me qytetarët, pasi mund ta përshtatë komunikimin duke u bazuar te preferencat dhe sjellja. Gjithashtu, mund të shërbejë si një mjet komunikimi nëpërmjet një chatbot-i. Për më tepër, IA-ja ofron mundësinë e analizimit të komunikimit të qytetarëve (p.sh., e-maile, postimet në media sociale, formularët e vërejtjeve) dhe të vlerësojë përshtypjet e publikut. Kjo i bën të mundur qeverisjes (vendore) që të trajtojë shqetësimet në mënyrë proaktive.

**Tabela e mëposhtme rendit disa mjete të tjera të dobishme për një platformë bashkëpunimi.**

GRUP I MJETEVE DHE TEKNIKAVE TË MENAXHIMIT TË NJOHURIVE	
FUNKSIONI	SHEMBUJ
Lidhja mes njerëzve	Komunitete praktikash; Mbështetje horizontale (nga homologët); Rrjetëzim social; Kafe njohurishë
Lidhja e njerëzve me njohuritë / të bazuarit në prova	Banka / Qendra dijesh; Aplikacione për telefona të zgjuar; Portale mësimi
Lidhja e njerëzve me praktikant më të mira	Mësime të nxjerra; Tregim historie; Komunitete praktikash; Forume profesionale
Mbështetje për njerëzit për të qendruar të përditësuar	Përmbledhje politikash; Portale on-line; Fletë lajmesh; Revista elektronike
Ndarje mësimesh	Analiza pas veprimeve; Analiza daljeje; Vlerësime pas projekteve
Lidhja e njerëzve me njohuritë e organizatave	Trajnime Hyrëse; Mentorim / mbështetje nga kolegët; Hartëzim i vlerave të njohurive
Burimi: Shërbimi Shëndetësor Kombëtar i Britanisë së Madhe, Shërbimi i Bibliotekës <sup>1</sup>	

<sup>1</sup> Burime: Herrera, F., Chan, G., Legault, M., Kassim, R. M., & Sharma, V. (2014). The digital workplace: Thin k, share, do. Transform your employee experience. Deloitte. // O’Riordan, J. (2020). Knowledge Management: Lessons for Local Government. *Institute of Public Administration: Local Government Research Series, 17*, 1-38.



### 3. SHËMBUJ NDËRKOMBETARË TË PRAKTIKAVE TË MIRA PËR PLATFOMAT E MENAXHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË NJOHURIVE.

Një seri platformash ndërkombëtare të mësimit dixhital, e të cilat fokusohen në mënyrë specifike në qeverisjen vendore, janë identifikuar dhe hulumtuar ekspertët nga HSLU, të cilët përshkruajnë veçoritë dhe shërbimet që ofrojnë platformat, si më poshtë:

#### 3.1 Shëmbull nga Polonia

Nëpërmjet **Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2020**, Polonia ka përcaktuar disa hapa të planifikuar për parashtrimin e **rregullave të njëtrajtshme për Qeverisjen elektronike** në zyrat e administratës së qeverisjes vendore. Strategjia përfshin plane, si krijimi i një qendre të vetme TI-je për të gjithë qeverinë, me qëllim zbatimin e rregullave të njëtrajtshme për Qeverisjen elektronike (p.sh., porositja e pajisjeve në nivel qendror). Krahas kësaj, digjitalizimi i administratës publike për të thjeshtuar proceset administrative dhe krijuar burime të strukturuar njohurish digjitale përbën një nga çështjet e trajtuara në strategjinë e vitit 2020. Kjo do të bëjë të mundur edhe auditimin e cilësisë së informacioneve publike, duke krijuar një platformë për shkëmbimin e informacionit.

Plani përfundimtar është që të sigurohet akses elektronik në gamën më të gjerë të mundshme të shërbimeve publike, duke bërë të mundur ndërveprimin e plotë me zyrën, si dhe trajtimin e çështjeve në distancë. Nëpërmjet përfshirjes së hapjes së të dhënave publike në zyrat e administratës qendrore dhe vendore, Polonia synon të përmirësojë punën e institucioneve publike dhe të lehtësojë punën e nëpunësve civilë, të rrisë përfshirjen e qytetarëve në çështjet publike, të krijojë një mjedis novator, si dhe të zgjidhë problemet sociale dhe ato ekonomike. Për ta përmbyllur, kjo strategji përbën një hap fillestar thelbësor për zhvillimin dhe zbatimin e një platforme për ndarjen e njohurive.

Sipas “Udhëzuesit të Praktikave të Mira për Hapjen e të Dhënave” të Polonisë, mund të merren në konsideratë rekomandimet si më poshtë: Të përdoret një standard i njëtrajtshëm gjatë ruajtjes së të dhënave. Në këtë mënyrë, kompjuteri/programi do të mund të dallojë të dhënat, çka do t'i mundësojë përdoruesit të krahasojë, analizojë ose ndërthurë të dhënat, ose t'i shfrytëzojë ato më tej (p.sh., për vizualizime). Gjatë ruajtjes së të dhënave, këshillohet të përdoren formate të dhënash të hapura, të lexueshme nga kompjuteri, që përmbajnë metadat: TXT, RTF, PDF, XPS, ODT, ODS, ODP, DOC, DOCX, XLS, XLSX, PPT, PPTX, dhe CSV.


Metadat u referohen informacioneve të strukturuar, që përdoren për të përshkruar burimet e informacionit ose objektet, duke mundësuar detaje mbi cilësitë e asetëve, çka lehtëson gjetjen, identifikimin dhe menaxhimin e tyre. Në çfarëdo portali me të dhëna të hapura duhet të përdoret një grup minimal metadatash. Gjatë ndarjes së të dhënave ose dokumenteve në portalin me të dhëna të hapura, ofruesi duhet (minimumi) t'i përfshijë metadat bashkë me titullin, fjalët kyç (fjalë ose togfjalësha që përshkruajnë shkurt burimin e informacionit), përshkrimin (përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së burimit të informacionit), si dhe shpeshtësinë e përditësimit (informacion mbi shpeshtësinë e përditësimit të të dhënave të mundësuar). Nëse informacioni i ndarë e ka burimin në internet, ofruesi duhet të përfshijë edhe adresën e URL-së së faqes së internetit ose nënfaqeve përkatëse prej nga janë marrë të dhënat. Krahas kësaj, duhet të

sigurohet që të dhënat të jenë me cilësi të lartë dhe të përditësuara. Përndryshe, të dhënat nuk do të vlejné për përpunim ose për ofrimin e shërbimeve të mëtejshme.

Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje hartimit të procesit të hapjes së të dhënave në çdo zyrë qeveritare, në mënyrë të tillë që bën të mundur shfrytëzimin e potencialit të plotë të njësisë së caktuar. Kjo nënkupton shmangien e sistemeve të veçuara të informacionit dhe tejkalimin e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet departamenteve. Prandaj, nevojitet zbatimi i politikave të brendshme për hapjen dhe strukturave horizontale të administrimit. Duke u rikthyer te shembulli i Polonisë, zbatimi efektiv i një politike për hapjen mund të ndjekë pesë hapa:

1. Marrja e vendimeve në nivel politik për të frymëzuar procesin e hapjes së të dhënave.
2. Caktimi i një drejtuesi për procesin e hapjes së të dhënave dhe përcaktimi i detyrave përkatëse.
3. Përcaktimi i angazhimit të nëpunësve të tjerë për të bashkëpunuar.
4. Hartimi i politikës për hapjen (përcaktimi i katalogëve të të dhënave, planifikimi i ndarjes së të dhënave, përcaktimi i standardeve, caktimi i personave përgjegjës për zbatimin).
5. Sigurimi i zbatimit dhe vlerësimit të politikës për hapjen.

Skema në vijim paraqet një panoramë gjithëpërfshirëse të proceseve dhe palëve të përfshira në një përpjekje për hapjen e të dhënave publike në shembullin e qytetit të Gdansk-ut, Poloni.



<sup>8</sup> Attachment No. 2 to the Regulation No. 306/14 of the Mayor of the City of Gdańsk, dated March 12, 2014. Available at: [http://otwartygdansk.pl/wp-content/uploads/2016/07/PMG\\_2014\\_6\\_306\\_zal013.pdf](http://otwartygdansk.pl/wp-content/uploads/2016/07/PMG_2014_6_306_zal013.pdf).

### 3.2 Shëmbull nga Republika Çeke

Shoqata “Unioni i Qytezave dhe Bashkive të Republikës Çeke” ka ngritur një **platformë bashkëpunimi dhe të nxëni**, ku përfshihen një sërë mjetesh të dobishme. Krahas panoramës së përgjithshme të të rejave më të fundit, platforma ofron informacione rreth projekteve të zhvilluara nga Uniuioni, të grupuara në kategori të ndryshme, si siguria, transporti, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe me BE-në, informatika, administrimi bashkiak, prokurimi, strehimi, subvencionimi, financimi bashkiak, kultura dhe turizmi, arsimit, mjedisi, energjetika, shërbimet e kujdesit social dhe shëndetësor, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Gjithashtu, ekziston dhe një kategori për **praktikën e mirë**, ku ndahen përvojat nga bashkitë e tjera lidhur me praktikat e mira dhe ato të këqija. Krahas kësaj, platforma paraqet një përmbledhje të asambleve të mbajtura dy herë në vit, konferencave dhe takimeve rajonale.

Në fushën **Action [Veprimi]** të platformës, mund të gjeni informacione rreth seminareve dhe trajnimeve të tjera profesionale të përshtatshme për punonjësit e bashkive. Kjo fushë përfshin edhe detaje rreth konkursit **Kryebashkiaku më i mirë**, ku kryebashkiaku i përzgjedhur si më i miri gjatë secilës periudhë zgjedhore vlerësohet me çmim që prej vitit 2010. Në këtë fushë përfshihen edhe konkurse të tjera, si **Fshati i vitit**. Fusha **About Us [Rreth nesh]** përmban dokumente, raporte vjetore dhe memorandume, ndërsa fusha **Membership [Anëtarësimi]** përfshin një hartë interaktive të të gjitha bashkive pjesëmarrëse. Krahas kësaj, mund të gjeni edhe fushën **Members [Anëtarët]**, të aksesueshme vetëm nëpërmjet kyçjes së regjistruar në platformë, ku ofrohet informacion lidhur me dhomat dhe komisionet e ndryshme. Fusha **Media** në platformë përfshin deklarata për shtyp, publikime, video, një galeri fotografish, si dhe një buletin elektronik.

Së fundi, në platformë ekzistojnë disa **mjete** të njohura si **produktet kryesore të shoqatës**, që nënkupton se janë mjetet më të dobishme. Një prej tyre është shërbimi i këshillimit juridik, që paraqet një sërë buletinesh me këshilla juridike. Duke klikuar te një nga lidhjet e integruara, përdoruesi referohet te një bazë të dhënash të jashtme, ku mund të kërkojë përgjigje për pyetjet juridike nëpërmjet një kutize kërkimi. Gjithashtu, aty ndodhet dhe një lidhje që shfaq një llogaritës taksash, që çdo bashki mund ta përdorë për të përlllogaritur vlerën e të ardhurave tatimore përkatëse për vitin pasardhës, duke u bazuar te parashikimi makroekonomik aktual. Platforma përfshin edhe një kalendar ku paraqiten detyrat e raportimit të të gjithë kryebashkiakëve sipas fushave përkatëse dhe afatet për përmbushjen e detyrimit. Krahas kësaj, ndodhet edhe aplikacioni My Diary [Ditari im], ku punonjësit mund të menaxhojnë detyrat që u janë caktuar. Është e mundur që të zgjidhen dhe të shfaqen vetëm fushat me rëndësi për përdoruesin, por edhe të shtohen detyra të tjera jashtë fushës së raportimit, duke krijuar një bazë të dhënash individuale. Në mënyrë që të mos shkelen afatet, ekziston edhe opsioni për të aktivizuar njoftimet nëpërmjet e-mail-it.

Sa i përket **trajnimin**, përfshihet një listë me kurse trajnimi në internet dhe përballë, që ofrohen posaçërisht për punonjësit e bashkive me çmim të reduktuar. Për secilin kurs përfshihet informacion i hollësishëm, si dhe datat e çmimit, bashkë me një lidhje drejt faqes së ofruesit të trajnimit, ku punonjësit e interesuar mund të aplikojnë për të ndjekur kurset.

Burimi: <https://www.smocr.cz/cs>

### 3.3 Shëmbull nga Suedia

Suedia njihet si një nga qendrat botërore kryesore të teknologjive digjitale dhe inovacionit teknologjik. Në vitin 2021, Agjencia Tatimore Suedeze dhe Autoriteti Përmbartimor Suedeze ndërmorën një shqyrtim të një platforme bashkëpunimi digjital që do të nxisë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të sektorit publik. Platforma e bashkëpunimit digjital është një mjet që supozohet të përfshijë sa më poshtë:

#### **Salla chat-i të përhershme**

Përdorimi i zgjidhjeve të përhershme të chat-it si mjete bashkëpunimi është i kufizuar. Gjithsesi, organizatat e sektorit publik kanë shfaqur interes të lartë për t'i përdorur këto mjete novatore. Salla e chat-it nuk shërben vetëm për komunikimin me dy kahe. Nëpërmjet një salle chat-i, përdoruesit kanë mundësinë që, për shembull, të fillojnë një takim menjëherë, të menaxhojnë ose modifikojnë dokumente. Gjithashtu, është e mundur që të kalohet lehtësisht ndërmjet pajisjeve të ndryshme, duke përdorur të njëjtën ndërfaqe. Zgjidhjet e mëposhtme të sallave të chat-it përmbushin kërkesat qeveritare dhe vlejné të merren parasysh; gjithashtu, ato mund të integrohen me zgjidhje të tjera për të ofruar funksionalitet të përmirësuar: *Element, Rocket.Chat, Mattermost*

#### **Videokonferenca**

Skype vijon të jetë platforma më e përdorur për videokonferenca. Megjithatë, ai nuk ofron mbështetje për sallat e përhershme të chat-it, dhe as mundësinë për zgjerimin e funksionalitetit të tij. Si rrjedhojë, këshillohet që të merren parasysh zgjidhjet e mëposhtme, që ofrojnë funksionalitet më të mirë dhe aftësi integrimi: *Jitsi, Pexip, Cisco Meeting*

#### **Kanban**

Bordi Kanban është një mjet menaxhimi projektsh i shumanshëm. Ai bën të mundur vizualizimin dhe menaxhimin e përmirësuar të detyrave në proces, çka sjell përmirësimin e eficiencës së rendit të punës. Në varësi të kërkesave, zgjidhjet Kanban vijnë me një sërë alternativash të ndryshme. Megjithatë, bazuar te praktika suedeze, zgjidhjet e mëposhtme janë alternativat më të përshtatshme, pasi mund të integrohen me platforma të tjera bashkëpunimi: *Nextcloud, Mattermost Boards, Stackfield, Jira*.

#### **Tabela e bardhë**

Tabelat e bardha janë një mjet i dobishëm për bashkëpunimin në distancë, që përdoren përpara, gjatë dhe pas një takimi në internet, për shembull. Ato përdoren shpesh për workshop-et dhe takimet në internet, dhe bëjnë të mundur dokumentimin e drejtpërdrejtë të rezultatit të një videokonferencë, çka redukton rendin e punës pas takimit. Shembulli suedez identifikon zgjidhjet e mëposhtme si alternativat më të dobishme për bashkëpunimin në qeverisjen vendore: *Collaboard, Nuiteq Stage, Bluescape, iObeya*.

#### **Ruajtja e dokumenteve**

Ruajtja e dokumenteve është thelbësore për bashkëpunimin ndërqeveritar, pasi mundëson akses të përbashkët te dokumentet me interes. Dy alternativat e mëposhtme konsiderohen si më të përshtatshmet në këtë drejtim: *Nextcloud, Storegate*.

Sipas shembullit suedez, në përgjithësi, është e mundur që një kod i praktikës së mirë të ndërthuret me zgjidhje TI. Megjithatë, për këtë nevojitet zbatimi i duhur në nivelin e autoritetit publik dhe, rrjedhimisht, fokusimi te faktorët e mëposhtëm: Niveli i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave i kërkuar për këtë lloj bashkëpunimi parashikon analizimin e riskut dhe klasifikimin e informacionit. Kjo do të thotë se nevojitet një nivel më i lartë detajimi i informacioneve të ngarkuara, që është i krahasueshëm me shembullin e Polonisë, ku nevoja për metadatën është tashmë e njohur. Krahas kësaj, të dhënat duhet të mbrohen nga zbulimi te persona të paautorizuar (p.sh., nëpërmjet vërtetimit të përdoruesve), duke siguruar se do të mbeten të aksesueshme për përdoruesit e autorizuar dhe se informacioni është i saktë. Duke qenë se platforma e bashkëpunimit do të përdoret çdo ditë për bashkëpunim të brendshëm dhe të jashtëm, dhe se do të ndahen të dhëna delikate, është thelbësore që të hartohet një plan vijimësie i besueshëm në rastin e hasjes së problematikave ose ndërprerjeve të funksionalitetit të platformës.

Burimi: <https://www.esamverka.se/download/18.4a6f5f6917d9204856518c5e/1639137082930/Digital%20collaboration%20platform%20for%20the%20public%20sector.pdf>

### 3.4 Shëmbull nga EPALE-s

EPALE i referohet **Platformës Elektronike për të Nxënit e të Rriturve në Evropë**. Anëtarët nga të gjitha vendet evropiane kanë akses te një gamë e gjerë mjetesh, të organizuara në shtatë kategori. Megjithatë, platforma nuk është e aksesueshme lirisht, por kërkon regjistrim.

Në kategorinë **Contribute [Kontributi]**, anëtarët kanë mundësi të gjejnë burime që lidhen me tema specifike, të aksesojnë blogun ku anëtarët e EPALE-s ndajnë mendimet e tyre, të shohin dhe regjistrohen në aktivitetet dhe veprimtaritë e ardhshme në Evropë, të lexojnë të rejat më të fundit rreth të Nxënit të të Rriturve, si dhe të kontribuojnë edhe vetë në komunitet (p.sh., duke shkruar artikuj lajmesh ose blogje).

Kategoria **Collaborate [Bashkëpunim]** ofron mundësinë për t'u bashkuar me grupet që punojnë për tema të caktuara nëpërmjet komuniteteve të praktikës ose hapësirave bashkëpunuese. Gjithashtu, ekzistojnë edhe alternativa kërkimi për organizata ose partnerë të tjerë. Përveç kësaj, në platformë ndodhet edhe një regjistër përdoruesish, që mundëson kërkimin dhe lidhjen me përdoruesit e tjerë dhe, së fundi, ndarjen dhe shkëmbimin e ideve të praktikës së mirë në seksionin e diskutimeve.

Në seksionin **Learn [Të nxënit]** në platformë, përdoruesit mund të aksesojnë MOOC-të (Kurset Masive të Hapura në Internet) dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre falë kurseve falas në internet. Krahas MOOC-ve, ndodhen edhe OER-të (Burimet Edukative të Hapura), që mund të ndahen dhe përdoren për të nxënit individual. Në Qendrën e Burimeve, përdoruesit kanë akses te një sërë materialesh, që mundësojnë njohjen me praktikën më të mira aktuale të edukimit dhe dokumentet e referencës (p.sh., studime rasti, raporte, dokumente politikash, etj.). Paketa e Burimeve, nga ana tjetër, ofron një sërë mjetesh dhe praktikash të mira nga komuniteti i EPALE-s. Veç kësaj, ekziston dhe një katalog kursesh që ofron mundësi trajnimi dhe certifikimi për profesionistët e të nxënit të të rriturve, si dhe një podcast dhe edicione informative.

Në kategorinë **MyCommunity [Komuniteti im]**, përdoruesit mund të eksplorojnë materialet më popullore në EPALE, të njihen me anëtarët më aktivë të komunitetit, të shohin rekomandimet e domosdoshme, të

pajisen me një Distinktiv EPALE për pjesëmarrje aktive, të lexojnë histori ndërkombëtare nga komuniteti dhe të eksplorojnë Panelin e kontribuesve më të mirë të platformës.

Ekziston edhe një kategori e quajtur **EU Policy [Politika e BE-së]**, ku përdoruesit mund të mësojnë më tepër rreth rolit dhe mbështetjes së BE-së për të nxënëit e të rriturve, të njihen me koordinatorët kombëtarë për të nxënëit e të rriturve, dhe të mësojnë rreth punës së grupit të ekspertëve në kuadër të të nxënëit të të rriturve.

Në seksionin **About [Rreth platformës]**, përdoruesit mund të mësojnë më tepër rreth platformës, p.sh., se çfarë është dhe si mund t'u shërbejë, kush përfshihet, kush është përgjegjës për përmbajtjen e saj, dhe se cilat janë palët e interesit kombëtare dhe të BE-së. Krahas kësaj, përdoruesit mund të gjejnë përgjigjet për pyetjet e shpeshta (FAQ) ose të kërkojnë ndihmë nëpërmjet formularit të kontaktit.

Në seksionin **MyEPALE**, përdoruesit mund të aksesojnë panelin dhe profilin e tyre me informacionet dhe preferencat e tyre.

Së fundi, platforma është e disponueshme edhe në version celular për pajisjet Android dhe iOS, që ofrojnë praktikitet dhe aksesueshmëri më të madhe.

Në tërësi, platforma EPALE përfaqëson një praktikë të mirë të një instrumenti për të nxënëit elektronik, pasi përfshin një sasi të konsiderueshme informacionesh dhe alternativash bashkëpunimi, por njëkohësisht ofron dhe një panoramë të përgjithshme dhe strukturë të dobishme. Sidoqoftë, integrimi i IA-së, për shembull në seksionin e ndihmës ose kërkimit të dokumenteve, mund ta përmirësojë më tej lehtësinë e përdorimit të platformës për përdoruesit. *Burimi: <https://epale.ec.europa.eu/en>*

#### **4. PRAKTIKA TË MIRA NDËRKOMBËTARE TË PLATFORMAVE DIXHITALE TË TË MËSUARIT PËR NJQV**

Më poshtë, nga eksperti kombëtar Shqiptar janë renditur platformat e suksesshme të mësimdhënies digjitale të identifikuar dhe të hulumtuara në nivel ndërkombëtar, duke u përqendruar posaçërisht në qeverisjen vendore, duke dhënë një përshkrim të shkurtër të asaj që ato ofrojnë:

- **Rrjeti Kanadez i Njohurive të Bashkive (CMKN)**: është një platformë bashkëpunimi që ofron kurse online, uebinare dhe burime për punonjësit e bashkive në mbarë Kanadanë. Ky rrjet mbulon tema të ndryshme të rëndësishme për qeverisjen vendore, duke përfshirë zhvillimin e politikave, menaxhimin e aktiveve dhe administratën bashkiake.
- **Trajnimet online të Akademisë për Qeverisjen Vendore (AQV) (në Filipine)**: janë programe trajnimi online për zyrtarët dhe punonjësit e qeverisjes vendore. Ato mbulojnë fusha të tilla si qeverisja vendore, planifikimi urban, menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe qëndrueshmëria mjedisore.
- **Akademia e e-Qeverisjes (në Estoni)**: ofron kurse dhe burime online në lidhje me qeverisjen digjitale, shërbimet elektronike dhe inovacionin e sektorit publik, të cilat janë të rëndësishme për qeverisjen vendore.



- [GovLoop \(SHBA\)](#): ofron burime, duke përfshirë kurse online dhe uebinare që përqendrohen në tema që lidhen me qeverinë për nëpunësit publikë të të gjitha niveleve.
- [ELGL \(Angazhimi i drejtuesve të qeverisjes vendore – SHBA, Kanada, Britani e Madhe, Izrael, Australi\)](#): ofron mundësi mësimi online, duke përfshirë uebinare dhe seminare të përshtatura për profesionistët e qeverisjes vendore, duke u fokusuar në udhëheqjen, menaxhimin dhe inovacionin në qeverisjen vendore.
- [Qendra e Kërkimeve dhe Shërbimeve Bashkiake \(MRSC – Uashington, SHBA\)](#): ofron burime dhe trajnime për nëpunësit në nivel qeverisje vendore. Ajo ofron uebinare, seminare dhe publikime që mbulojnë çështje ligjore dhe të politikave të rëndësishme për qeverisjen vendore.
- [Qendra e të Nxëniet e Shoqatës për Qeverisjen Vendore \(LGA\) \(Mbretëria e Bashkuar\)](#): është një qendër mësimdhënie, e cila ofron kurse dhe burime online për nëpunësit e qeverisjes vendore për tema të ndryshme si udhëheqja, qeverisja, financat dhe ofrimi i shërbimeve.
- [Aqjencia e Menaxhimit të Qeverisjes Vendore \(LGMA\) \(Irlandë\)](#): ofron një sërë burimesh digjitale të nxëniet dhe mundësi trajnimi për nëpunësit e qeverisjes vendore në Irlandë. Ato mbulojnë tema të tilla si qeverisja, menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve.
- [Qendra për Studimet e Qeverisjes Vendore në Finlandë \(Finlandë\)](#): ofron kurse online dhe burime të përshtatura për nevojat e profesionistëve të qeverisjes vendore në Finlandë. Kurset mbulojnë tema të ndryshme në lidhje me qeverisjen, administrimin dhe menaxhimin në nivel vendor.
- [Akademia Gjermane për Bashkitë \(Deutsche Kommunale Akademie für Verwaltungsmanagement\)](#): ofron platforma dhe burime digjitale të të nxëniet për nëpunësit e qeverisjes vendore në Gjermani. Ajo ofron kurse, trajnime dhe seminare që mbulojnë tema të tilla si administrata publike, financat dhe udhëheqja.
- [E-Sam \(Suedi\)](#), është një program i udhëhequr nga anëtarët për bashkëpunimin mes 39 autoriteteve suedeze, në të cilin anëtarët përfitojnë nga mundësitë e digjitalizimit për të lehtësuar përdorimin e burimeve të përbashkëta në një mënyrë efikase.
- [Sindikata e qyteteve dhe bashkive të Republikës së Çeke \(SMO\)](#): është një shoqatë e cila kryesisht përqendrohet në veprimtarinë e kryetarëve të bashkive dhe përfaqësuesve bashkive, të cilët, përveç detyrave në qytetin ose komunën e tyre, merren edhe me probleme të përgjithshme të vetëqeverisjes. Aktivitetet e tyre më pas koordinohen dhe vendimet e organeve të sindikatës zbatohen nga nëpunësit e zyrës së sindikatës.
- [Instituti Evropian për Administratën Publike \(EIPA\)](#): ofron një gamë të gjerë burimesh, si kurse, trajnime, seminare dhe module të mësimdhënies online për administratën publike, duke përfshirë tema të rëndësishme për nëpunësit dhe profesionistët e qeverisjes vendore. Edhe pse jo ekskluzivisht për pushtetin vendor, shumë nga ofertat e tyre janë të rëndësishme për këtë sektor.

Përveç tyre, sot ka edhe shembuj të shumtë të platformave të qarta të mësimi digjital në nivel ndërkombëtar, të cilat mund të mos kenë lidhje të drejtpërdrejtë me temën e qeverisjes vendore, por që janë shumë të *suksesshme në mënyrën se si e formësojnë mësimin digjital*. Të tilla janë:

- **Coursera**: që nga viti 2012, ajo ofron më shumë se 7,000 kurse online, certifikime dhe diploma në një larmi lëndësh, duke punuar me më shumë se 300 universitete dhe biznese;
- **Udemy**: është një platformë ku ekspertët mund të krijojnë dhe të shesin kurset e tyre. Ai ofron një përzgjedhje të gjerë të kurseve për tema të ndryshme, nga programimi dhe dizajni deri te zhvillimi personal dhe biznesi.
- **LinkedIn Learning**: që nga viti 1995, ai ofron një bibliotekë të gjerë të kurseve me video të dhëna nga ekspertë të industrisë. Ai mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë biznesin, teknologjinë dhe aftësitë krijuese, në katër kategori: biznes, kreativitet, teknologji dhe certifikime.
- **Udacity**: që nga viti 2011, ai ofron kurse të hapura në internet, trajnime profesionale për profesionistët, veçanërisht në fusha si programimi, shkenca e të dhënave, inteligjenca artificiale dhe marketingu digjital.
- **Skillshare**: që nga viti 2011, ajo përqendrohet më shumë në reklamim, biznes, dizajn, modë dhe stil, film dhe video, ushqim dhe pije, muzikë, fotografi, lojëra, teknologji dhe shkrim e botim.
- **FutureLearn**: që nga viti 2012, është pjesë e sistemeve të Universitetit Global, me më shumë se 260 partnerë në Mbretërinë e Bashkuar, si në industri ashtu edhe në qeveri, si dhe 20 milionë nxënës të regjistruar. Ajo ofrojnë kurse me lëndë të ndryshme, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, biznesin, mësimin e gjuhës dhe shumë të tjera.

## 5. RASTE TE PLATFORMATVE TE MËSIMIT DIGJITAL NË SHQIPËRI.

Pas vitit 2010, edhe në Shqipëri janë ndërmarrë disa nisma për krijimin e sistemeve të menaxhimit të njohurive në nivel qendror dhe të qeverisjes vendore.

Në këtë drejtim, nismat private, kryesisht në sistemin akademik, kanë qenë më të suksesshme dhe më të qëndrueshme.

Më poshtë paraqiten sistemet e identifikuara dhe të hulumtuara (nga jashtë):

### 5.1 Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)

Me tre komponentët e saj kryesorë, ASPA e ushtron veprimtarinë e saj si më poshtë:

Vlerësimi i cilësisë

- ASPA është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së programeve të trajnimit për shërbimin civil.
- Ajo ofron bashkëpunim për të gjitha institucionet ose organizatat e shoqërisë civile që duan të ofrojnë programe trajnimi në përputhje me standardet e paracaktuara të cilësisë.
- Certifikimi nga ASPA vërteton se programi i trajnimit është në përputhje të plotë me standardet e paracaktuara, të cilat përditësohen dhe përmirësohen vazhdimisht, sipas nevojave të administratës publike.
- Të gjitha materialet e reja të trajnimit i nënshtrohen vlerësimit të cilësisë, sipas metodologjisë dhe instrumenteve të paracaktuara.

## **E-Biblioteka**

- “E-biblioteka” është një shërbim i krijuar për të ofruar mundësi të mira informimi për të gjithë punonjësit e administratës publike dhe jo vetëm, për të kërkuar dhe për t’u informuar për dokumentet teknike të punës së administratës publike si: broshura, udhëzime, dokumente metodologjike, raporte vlerësimi, etj.
- “E-biblioteka” është ndërtuar për të ruajtur dokumente të klasifikuara mirë.
- Ajo u krijua për të kërkuar, ruajtur, krijuar një historik personal të shkarkimeve, apo edhe për t’u kthyer në materialet e përdorura më parë.

## **E-Mësimi**

- E-mësimi është një instrument shumë i dobishëm që mund të përdoret individualisht nga kushdo që dëshiron të mësojë dhe të përmirësojë njohuritë e veta. Ky shërbim është krijuar posaçërisht për të mundësuar mësimin nga kompjuteri personal dhe mund të arrihet përmes internetit gjatë 24 orëve në ditë, çdo ditë të javës, nga kudo.
- Sistemi SMN mbështet deri në 5 000 përdorues të regjistruar, dhe 200 përdorues që mund të përdorin sistemin në të njëjtën kohë.

### **5.2 Administrata.al, pjesë e Departamentit të Administratës Publike (DAP)**

*Administrata.al* është një platformë që përbën një risi në menaxhimin e burimeve njerëzore, e financuar nga Qeveria Zvicerane dhe e zbatuar nga Këshilli i Evropës. Ajo rezultoi të jetë një mjet i domosdoshëm për administratën publike shqiptare, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë.

Përdorimi i platformës lehtësoi ndërveprimin dhe komunikimin e informacionit në kohë reale, veçanërisht gjatë punës në distancë.

Platforma “*administrata.al*” siguron shkëmbimin e praktikave dhe përvojave në funksion të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore për të gjitha nivelet e administratës.

Pjesë e saj janë forumet e diskutimit, si dhe biblioteka digjitale.

### **5.3 Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS), pjesë e DAP-it**

Ndryshe i njohur si HRMIS, ky regjistër është një bazë të dhënash unike elektronike, në të cilën kryesisht ruhen, përpunohen dhe menaxhohen informacionet për burimet njerëzore aktive, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet dhe njësitë e pavarura.

#### **5.4 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Pas disa vite diskutime, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë arriti, në tetor 2012, një marrëveshje me qeverinë austriake, përmes një kredie të butë, për zbatimin e një platforme të e-Edukimit, të ofruar nga shoqëria austriake Bit Media.

Platforma ofroi:

- Portalin Qendror për krijimin e mesazheve elektronike dhe hyrjen;
- Kurse të mësimit elektronik për trajnime në TIK; gjuhë gjermane dhe angleze, si dhe disa lëndë të tjera;
- Sistemin e krijimit të përmbajtjes digjitale të e-mësimit (programe që bëjnë të mundur që përdoruesit të krijojnë aplikacione multimediale).

#### **5.5 RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar)**

